



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja o) dhe nenit 40.2 shkronja i) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008), nenit 7 paragrafi 1 dhe 2, nenit 10 dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, nenit 5, nenit 6 dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 17/2019 për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtime listës rezervë dhe vendosjen e tyre në regjistrin komunal të adresave, nenit 5 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 14/2019 për caktimin e emërimit dhe numërimit të adresave për zona të qarkullimit publik ndërtesa shtëpi objekte dhe parcela kadastrale të lira, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, neni 32.2 i Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës në Dragash, pas propozimit të kryetarit të komunës, në mbledhjen e mbajtur me datën 29.07.2025 pas rishqyrtimit të vendimit dhe votimit paraprak, miraton këtë:

VENDIM

PËR RISHQYRTIMIN E VENDIMIT 01Nr. 060/01-11859-2 të dt. 30.06.2025

- I. Miratohet **rishqyrtimi** i Vendimit me nr. protokolli 01Nr. 060/01-11859-2/25, datë 30.06.2025, që ka të bëjë me **miratimin e plotësimit të listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Dragashit.**
- II. Bazuar në shkresën e **Ministrit së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)**, me nr. protokolli 5160-2/25, datë 15.07.2025, e cila pas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit e ka **obliguar Komunën e Dragashit që të rishqyrtojë vendimin në fjalë dhe të ndjekë procedurat ligjore sipas legjislacionit në fuqi.**
- III. Komuna e Dragashit, në përputhje me shkresën e MMPHI, **ka dërguar paraprakisht listën rezervë për shqyrtim teknik në Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) dhe ka bërë korrigjimet teknike përkatëse në listën e emrave.**
- IV. **Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista e përditësuar me emërtimet e reja në listën rezervë për rrugët dhe sheshet në territorin e Komunës së Dragashit.**
- V. Vendimi, hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8 dhe nenit 9 të Ligjit Nr.08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 24/2024'' dhe pas publikimit në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

Shtojcë: 01Nr.060/01-11859-2/25 i dt. 30.06.2025

KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

01-Nr. 060/01-11859-2/25

Datë 29.07.2025



Kryesuesja e Kuvendit

Arijeta Skeraj



Duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës së Dragashit për Formimin e Komisionit për Emërtimin e Rrugëve, Sheshëve dhe Lagjeve në Komunën e Dragashit me nr. të protokollit 01Nr.060/01-31085-4/24 i dt. 18.12.2024, në përbërje prej 1. Nexhat Selaj, 2. Gazmend Ramadani, 3. Munir Jonuzi, 4. Dreni Myrtezani dhe 5. Usamedin Haruni, ku kemi pasur obligim që të përpilojmë listën reserve për emërtimin e rrugëve, sheshëve dhe lagjeve në territorin e Komunës së Dragashit, pas punës në terren i porpozojmë Kuvendit të Komunës që të miratojë plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve sheshëve në Komunën e Dragashit si më poshtë:

Nr.	Emrat e Rrugëve	Sheshet
1	Tranzit Bruti	Samidin Muhameti
2	Qarre	
3	Haxhi Rrahmani	
4	Shaban Tahiri	
5	Kroji i Madh	
6	Shaniu	
7	Kroji i Naltë	
8	Kastrate	
9	Ysyle	
10	Lugu i Qelës	
11	Gratë 1913	
12	Vakofe	
13	Pllarie	
14	Tenova	
15	Orrnicat	
16	Porospore	
17	Kodra e Lisit	
18	Ara e Gazit	
19	Xheksina	
20	Kodra e Gatë	
21	Pikniku	
22	Shpella	
23	Lugu i Madh	
24	E Gores	
25	Hisari	
26	Stani i Ramës	
27	Prrojblece	
28	Qafëza	
29	Kroni i Ftohët	
30	Kulla	
31	Kodra e Madhe	
32	Kodra Vogël	
33	Ahu	
34	Kodra e Arës	
35	Dushki	
36	Mahalla te Xhamia	
37	Matrake	
38	Gabuja	
39	Xhenet Raynek	
40	Yllfete Humolli	
41	Ksulza	
42	Te Qafa	
43	Tumza	
44	E Beshikes	
45	Salim Rexhepi	
46	Rexhep Shyqeriu	
47	Rizan Halimi	
48	Luftëtarët e Kosharës	
49	Dardanët	
50	Ushtar Kavaja	
51	Livadi i Begut	
52	E Shtaves	
53	E Romajve	
54	Mulla Qamili	
55	Haxhi Nuridini	
56	Xhemali Mejzini	
57	Baba Hoxhë	
58	E Fejzës	
59	Trupajt	
60	Fusha	
61	Zidina	
62	Guri i Rrushit	
63	Pishat e Reja	
64	Puškarska	
65	Omer Lutfi Paçarizi	
66	Jonuz Jonuzi	
67	Bela Džamija	
68	Mahalei Kebir	
69	Hamit Isijami	
70	Dëlmërit Tosuni	
71	Vejsel Hamza	
72	Dëjrena Loka	

73	Gjirit		
74	Qerëza		
75	E Brisë		
76	E Uapushnikut		
77	Sharrit		
78	Alija Ziza		
79	E Vjetër		
80	Pod Selo		
81	Nad Selo		
82	Drdov Sokak		
83	Igranaolca		
84	Šntinica		
85	Mallit		
86	Bres		
87	Džajkoska		
88	Avina Livada		
89	Ljiviraven		
90	Pozlipočica		
91	Jezero		

Kryesuesja e Kuvendit
Arijeta Skeraj



A. Skeraj



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja o) dhe nenit 40.2 shkronja i) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008), nenit 7 paragrafi 1 dhe 2, nenit 10 dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, nenit 5, nenit 6 dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 17/2019 për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtime listës rezervë dhe vendosjen e tyre në regjistrin komunal të adresave, nenit 5 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 14/2019 për caktimin e emërimit dhe numërimit të adresave për zona të qarkullimit publik ndërtesa shtëpi objekte dhe parcela kadastrale të lira, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, neni 32.2 i Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës në Dragash, pas propozimit të kryetarit të komunës, në mbledhjen e mbajtur me datën 30.06.2025 pas shqyrtimit dhe votimit paraprak, miraton këtë:

V E N D I M

1. **APROVOHET** plotësimi i listës rezervë për Emërtimin e Rrugëve dhe Shesheve në Komunën e Dragashit, sipas propozimit të komisionit për hartimin e listës rezervë, i themeluar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Dragashit me nr. të protokollit 01Nr.060/01-31085-4/24 I dt. 18.12.2024.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista me emërtimet e reja të listës rezervë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Ambientit.
4. *Hyrja ne fuqi e vendimit:* Vendimi, hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8 dhe nenit 9 të Ligjit Nr.08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 24/2024" dhe pas publikimit në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH
01-Nr. 060/01-11859-2/25
Datë 30.06.2025



Kryesuesja e Kuvendit
A. Skeraj
Arijeta Skeraj

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 02.07.2025 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Vendimin 01 Nr. 060/01-11859-2/25 aprovohet plotësimi i listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Dragashit, miratuar nga Kuvendi Komunal i Dragashit, datë 30.06.2025.

MMPHI pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave kërkon nga Kuvendi Komunal i Dragashit:

RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Vendimi 01 Nr. 060/01-11859-2/25 aprovohet plotësimi i listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Dragashit, miratuar nga Kuvendi Komunal i Dragashit, datë 30.06.2025.

ARSYETIMI

MMPHI pas shqyrtimit të vendimit të lartcekur konstatoi se:

Emrat e rrugëve, para se të dërgohen për miratim në Kuvendin Komunal, duhet të dërgohen më parë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) për shqyrtim teknik, sipas Udhëzimit Administrativ nr. 16/2019 për Procedurat e Krijimit dhe Administrimit të Regjistrat Komunal të Adresave dhe Regjistrat Shtetëror të Adresave, neni 9, pika 1.3. Komuna nuk e ka dërguar këtë listë për shqyrtim paraprak në AKK, gjë që përbën shkelje të procedurës.

Komentet teknike për emrat e propozuar:

5. **Kroji madh**, Ky emër paraqitet dy herë në listë. Nuk lejohet përsëritja e emrave brenda territorit të një komune.
7. **Kroji I kaltë**, Verifikoni drejtshkrimin; duhet të shkruhet: *Kroji i Kaltë*.
8. **Rudina vogël**, Ekziston një emër i ngjashëm në sistem. Emrat me ngjashmëri në drejtshkrim nuk lejohen.
11. **Guzhde**, ky emër ekziston në sistem, nuk lejohet dyfishimi i emrave brenda territorit të komunës, është emër i ngjashëm me emrin Guzhde, emrat e ngjashëm në drejtshkrim nuk janë të pranueshëm.
- 11A. **Guzhde 2**, është emër i ngjashëm me emrin Guzhde, emrat e ngjashëm në drejtshkrim nuk janë të pranueshëm.
15. **Fusha 2**, është emër i ngjashëm me emrin Fusha 1, emrat e ngjashëm në drejtshkrim nuk janë të pranueshëm.
16. **Mulliri**, ky emër ekziston në sistem, nuk lejohet dyfishimi i emrave brenda territorit të komunës, emrat e ngjashëm në drejtshkrim nuk janë të pranueshëm.
17. **Domni 2**, ky emër ekziston në sistem, nuk lejohet dyfishimi i emrave brenda territorit të komunës, emrat e ngjashëm në drejtshkrim nuk janë të pranueshëm.
- 18A. **Mungon emri i rrugës**.
19. **Fusha 1**, është emër i ngjashëm me emrin Fusha 2, emrat e ngjashëm në drejtshkrim nuk janë të pranueshëm.
23. **Beqirja**, emrat e ngjashëm në drejtshkrim nuk janë të pranueshëm, ekziston në sistem emër i ngjashëm (Beqiraj).
24. **Rudina e madhe**, Ekziston një emër i ngjashëm në sistem, emrat e ngjashëm në drejtshkrim nuk janë të pranueshëm.
25. **Viktimat 1913**, nuk lejohen emrat që japin ndjesi të keqe.
26. **Kodra lisit**, verifiko drejtshkrimin, (Kodra e Lisit).
27. **Ara Gazit**, Verifiko drejtshkrimin (Ara e Gazit).
29. **Kodra gat**, Verifiko drejtshkrimin (Kodra e Gatë).
30. **Norxhonza-Shtegu**, duket si emër i pakuptimtë, shenjat nuk lejohen te emri i rrugës.

33. Lugi madh, Verifiko drejtshkrimin (Lugu i Madh).
34. Rruga e Gores, fjala Rruga duhet të hiqet prej emrit të rrugës (E Gores).
36. Stani Ramës, Verifiko drejtshkrimin (Stani i Ramës).
39. Vllaçia, emrat e ngjashëm në drejtshkrim nuk janë të pranueshëm (emër i ngjashëm me Vllaçia 2).
40. Kroni i ftohët, Verifiko drejtshkrimin (Kroni i Ftohët).
41. Udha e Re, fjala e re nuk duhet të përdoret për emërtim të rrugës.
43. Kodra madhe, verifiko drejtshkrimin (Kodra e Madhe).
44. Kodra vogël, verifiko drejtshkrimin (Kodra e Vogël).
48. Mejdani, Ekziston një emër i ngjashëm në sistem, nuk lejohet dyfishimi i emrave brenda territorit të komunës, emrat e ngjashëm në drejtshkrim nuk janë të pranueshëm.
51. Vllaçia 2, emrat e ngjashëm në drejtshkrim nuk janë të pranueshëm (emër i ngjashëm me Vllaçia).
52. Mbretresha Teuta, Ekzistojnë dy emra të ndjetë në listë, nuk lejohet dyfishimi i emrave të rrugëve brenda territorit të komunës, ky emër ekziston në sistem, nuk lejohet dyfishimi i emrave brenda territorit të komunës.
53. Janet Reineck, emrat në gjuhët e huaja nuk përdoren, duhet të përshtaten në gjuhën shqipe.
54. Yrfete Humolli, Ekziston emër i njëjtë në listë, nuk lejohet dyfishimi i emrave brenda territorit të komunës, verifiko drejtshkrimin (Ylfete Humolli).
55. Medeline Albright, Ekzistojnë dy emra të njëjte në listë, nuk lejohet dyfishimi i emrave të rrugëve brenda territorit të komunës, emrat në gjuhët e huaja nuk përdoren, duhet të përshtaten në gjuhën shqipe.
59. Kroji i Madh, ky emër ekziston dy herë në listë, nuk lejohet dyfishimi i emrave brenda territorit të komunës.
60. Sheshi Samidin Muhameti (Bresane), emrat me më shumë se 30 karaktere nuk lejohen, fjala shesh duhet të hiqet nga emri i rrugës, shenjat nuk lejohen te emrat e rrugëve, emrat e rrugëve nuk rekomandohen me më shumë se dy fjalë.
64. Luftetaret e Koshares, Verifiko drejtshkrimin (Luftëtarët e Koshares).
66. Besenaj, Ekziston një emër i ngjashëm në sistem, nuk lejohet dyfishimi i emrave brenda territorit të komunës, emrat e ngjashëm në drejtshkrim nuk janë të pranueshëm.
67. Berisha, Ekziston një emër i ngjashëm në listë, nuk lejohet dyfishimi i emrave brenda territorit të komunës, emrat e ngjashëm në drejtshkrim nuk janë të pranueshëm.
68. Berishaj, Ekziston një emër i ngjashëm në listë, nuk lejohet dyfishimi i emrave brenda territorit të komunës, emrat e ngjashëm në drejtshkrim nuk janë të pranueshëm.
69. Indrit Cara - Ushtar Kavaja, shenjat nuk lejohen te emrat e rrugëve, emrat e rrugëve nuk rekomandohen me më shumë se dy fjalë.
70. Medeline Albright, Ekzistojnë dy emra të njëjtë në listë, nuk lejohet dyfishimi i emrave të rrugëve brenda territorit të komunës, emrat në gjuhët e huaja nuk përdoren, duhet të përshtaten në gjuhën shqipe.
71. William Walker, Ekziston emri i njëjtë në sistem, nuk lejohet dyfishimi i emrave të rrugëve brenda territorit të komunës, emrat në gjuhët e huaja nuk përdoren, duhet të përshtaten në gjuhën shqipe.
72. Bill Clinton, Ekziston emri i njëjtë në sistem, nuk lejohet dyfishimi i emrave të rrugëve brenda territorit të komunës, emrat në gjuhët e huaja nuk përdoren, duhet të përshtaten në gjuhën shqipe.
73. Ismail Qemali, Ekziston emri i njëjtë në sistem, nuk lejohet dyfishimi i emrave të rrugëve brenda territorit të komunës.
74. Mbretëresha Teutë, Ekzistojnë dy emra të njëjtë në listë dhe në sistem, nuk lejohet dyfishimi i emrave brenda territorit të komunës.

75. Yrfete Humolli, Ekziston emër i njëjtë në listë, nuk lejohet dyfishimi i emrave brenda territorit të komunës, verifiko drejtshkrimin (Ylfete Humolli).

Nga ajo që u tha më lartë, të vepohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e Ligjit Nr. 08/ L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.